

GJENDJET KRITIKE

Çfarë duhet të bëjmë nëse në fermë shpendët sëmurën ose ngordhin?

Në rast se në fermë vërehen shpendë të sëmurë ose të ngordhur duhet:

- Të lajmërohet menjëherë veterineri i zonës.
- Shpendët e sëmurë duhet të veçohen dhe nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë kontakti me shpendët e tjerë.
- Njerëzit që merren me shpendët e sëmurë duhet të mbrojnë veten me maska, dorashka, çizme, etj. Pasi të jenë veçuar shpendët e sëmurë, mjetet mbrojtëse duhet të digjen dhe personat duhet të dezinfektojnë veten e tyre.
- Të dezinfektohen dhe spërkaten me gëlqere të pa shuar toka dhe vendi ku janë mbajtur shpendët e sëmurë.
- Të këshillohet drejtpërdrejtë veterineri rreth procedurave që duhen ndjekur për të eliminuar shpendët.

Çfarë duhet të bëjmë nëse nuk ndjeheni mirë?

Nëse ju apo një anëtar i familjes tuaj ka ethe apo shqetësime në aparatit e frymëmarrjes dhe ka qenë në kontakt me shpendë, sidomos nëse këto shpendë kanë qenë të sëmurë, duhet të shkojë menjëherë në një qendër shëndetësore.

Mjeku duhet të informohet nëse ju keni pasur kontakt direkt me shpendë të sëmurë ose të ngordhur.



KËSHILLA PRAKTIKE


Duhet gjithnjë të kërkon këshilla rreth gripit të shpendëve nga veterineri i shërbimit pranë Njesisë Administrative.

- Në fermat e infektuara, duhet të shmangët çdo kontakt me shpendët apo produktet e tyre.
- Shitësit apo njerëzit që blejnë shpendë të gjallë, njerëzit që përgatisin shpendët e therur për konsum shtëpiak apo për restorante, duhet të respektojnë normat e higjienës. Ata duhet të paktën të përdorin dorashka dhe të lajnë duart here pas here.
- Mos konsumoni shpendë të egër, sepse ju rrezikoni të infektoni fermën me gripin e shpendëve ose mund të infektoheni vetë ndërsa i përgatisni këto shpendë për gatim.
- Fermerët nuk duhet kurrë të shesin shpendë ose vezë kur shpendët në fermë duken jo të shëndetshëm.
- Në fermë vetëm një person duhet të kujdeset për shpendët. Ky person duhet të jetë i rritur dhe në gjendje të mirë shëndetësore.
- Në fermat e infektuara, duhet të shmangët çdo kontakt me shpendët apo produktet e tyre. Personat e vetëm që mund të jenë në kontakt me shpendët janë veterinerët, të cilët duhet të jenë të pajisur me veshje mbrojtëse.



GRIP I SHPENDËVE

ÇFARË DUHET TË DINË RRITËSIT E SHPENDËVE!



NJOHURI TË PËRGJITHSHME

Çfarë është gripi i shpendëve?

Gripi i shpendëve është një sëmundje infektive e shkaktuar nga tipi A i viruseve të influencës, që prek disa lloje shpendësh shtëpiakë dhe të egër.

Gripi i shpendëve është një sëmundje e rrezikshme pasi mund të sëmurë dhe të ngordhë të gjithë shpendët e fermës. Atij i duhet kushtuar rëndësi e veçantë, sepse përhapet shumë shpejt.

Si përhapet gripi i shpendëve?

Zogjtë shtegtarë (kryesisht patat dhe rosat) janë bartësit natyralë të këtij virusi. Megjithatë këta zogj janë bartës të sëmundjes, ata nuk shfaqin shenja të saj.

Zogjtë shtegtarë shërbejnë si një mjet për përhapjen e sëmundjes tek shpendët shtëpiakë, që janë shumë të ndjeshëm nga ky virus.

Përveç shpendëve shtegëtarë, sëmundja mund të hyjë në fermë edhe nëpërmjet disa mënyrave:

- Nëpërmjet personave të cilët vijnë në fermën tuaj pasi kanë qenë në ndonjë ambient të ndotur me viruse (p.sh tregu i kafshëve, ndonjë fermë tjetër, thertoret, etj). Këta persona mund të transportojnë viruset me anë të veshjeve, këpucëve, mjeteve, etj.
- Blerja ose dhurimi i shpendëve që vijnë nga ferma të cilat kanë shpendë të infektuar. Blerja ose marrja si dhuratë e shpendëve përbën rrezik edhe pse shpendët në dukje mund të mos jenë të sëmura.
- Qentë ose macet e shtëpisë sjellin shpendë të egër ose shpendë shtëpiakë të ngordhur. Për këtë arsye shpendët duhet të mbahen të veçuar nga kafshët e fermës.
- Plehu që blini ose merrni jashtë fermës mund të jetë i ndotur me viruse gripale.


SIGURIA USHQIMORE

A mund të konsumojmë pula dhe vezë?

Agjencitë ndërkombëtare si Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) dhe Organizata Ndërkombëtare e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) kanë deklaruar se konsumi i pulave dhe i vezëve të gatuar në temperatura të larta është i sigurt. Temperaturat e larta mbi 70°C e shkatërrojnë virusin.

Për të pasur një ushqim të sigurt duhet të zbatohen të gjitha normat higjienike si dhe rekomandimet e mëposhtme:

- Blini pulat dhe nënproduktet e tyre vetëm në dyqane të certifikuara dhe që kanë norma të larta higjienike;
- Mos blini pula të gjalla, pasi sëmundja mund të përhapet nëpërmjet shpendëve të gjallë;
- Zgjidhni vezë të freskëta të cilat nuk kanë shenja glasash mbi lëvozhgë;
- Mos blini vezë të cilat kanë lëvozhgë të thyer.
- Mishi i shpendëve duhet të gatuhet plotësisht përpara konsumit.
- Vezët duhet të gatuhet derisa të verdhat dhe të bardhat të mpiksen plotësisht.
- Lanë duart me ujë të ngrohtë të rrjedhshëm dhe sapun pas përgatitjes së mishit apo vezëve.
- Pastroni me sapun dhe ujë të ngrohtë të rrjedhshëm, enët dhe sipërfaqet që kanë qenë në kontakt me shpendët e pagatuar ose me vezët.



KUJDESI NDAJ FERMAVE

Masat parandaluese në fermat e rritjes së shpendëve.

Gripi i shpendëve mund të kalojë nga ferma në fermë nëpërmjet shumë mënyrave direkte dhe indirekte. Për të ndaluar hyrjen e sëmundjes në fermë, fermeri duhet të kryejë disa veprime.

Karantina:

Nëse fermerit i nevojitet të marrë disa shpendë të rinj, ai duhet t'i fusë ato në një vend të mbyllur dhe të veçuar nga kontakti me kafshët e tjera të fermës për të paktën 21 ditë.

Shpendët e rinj duhet të kontrollohen çdo ditë. Shpendët e rinj mund të duken të shëndetshëm, por asnjë nuk mund ta dijë nëse ato e mbartin virusin ose jo. Nëse pas 21 ditësh, shpendët e rinj janë akoma të shëndetshëm, ato mund të bashkohen me pjesën tjetër të shpendëve.

Si të mbrojmë fermën?

Në vendin tonë është konfirmuar prania e gripit të shpendëve dhe duhet ta konsiderojmë atë pranë fermës tonë.

Për të mbrojtur fermën janë të nevojshme të merren masa mbrojtëse si:

- Mos lejoni shpendët tuaj të ushqehen e të lëvizin lirshëm nëpër fusha!
- Mbajini shpendët në një vend të rrethuar me rrjetë të imët ose më mirë kotec, për të mos lejuar kontaktet e tyre me shpendë të tjerë!
- Risni masat higjienike në fermë, duke pastruar oborrin e fermës, vendin ku rrinë shpendët, pajisjet, vendin ku ushqehen shpendët, etj!
- Kujdesuni për shëndetin e tyre dhe sigurohuni që shpendët të kenë ujë të pastër dhe ushqim të përshtatshëm!
- Një kafshë në kushte të mira ka rezistencë më të madhe ndaj sëmundjes!